

**PKR.nr.387/17**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, në përbërje nga Kryetarja e trupit gjykues, Valbona Musliu-Selimaj, me procesmbajtësen Lindita Sylejmani, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale, kundër të akuzuarit **A.Z**, për shkak të veprës penale, Grabitja, nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.254/2017, të datës 19.12.2017, në seancën e shqyrtimit fillestar të hapur, të mbajtur me datën 27.02.2018, në praninë e Prokurorit të shtetit, Hivzi Bajraktari, të akuzuarit A.Z me mbojtësin e tij avokat G.H sipas autorizimit dhe të dëmtuarës dëshmiatre V.K, në bazë të nenit 366 të KPPK-së, në të njëjtën ditë, me datë **27.02.2018**, mori dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I akuzuari: A.Z**, nga i ati S. dhe nënës F, e vajzërisë Sh, i lindur me... në fshatin O. Komuna e D., me vendbanim në D., në rrugën "A.M" nr., me numër personal..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, realizon pensionin e veteranit të luftës, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e arrestit shtëpiak nga data 12.12.2017 deri më datë 27.02.2018.

## **ËSHTË FAJTOR**

### **SEPSE:**

Me datën 12.12.2017, rreth orës 07:45 minuta, në Qendrën e re Tregtare në Glogovc, në lokalin "W.U", me kanosje serioze për ta sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër ka përvetësuar pasurinën e lujtshme të personit tjetër, me qëllim që ti sjell vetës dobi pasurore të kundërligjshme, në atë mënyrë që derisa e dëmtuara V.K pasa kishte hapur lokalin, ka hyrë i akuzuari i maskuar dhe me armë të ftohtë me thikë në dorë, i është drejtuar me zë të lartë të dëmtuarës duke i thënë "qiti paret", e dëmtuara nga tronditja dhe frika ka filluar të qaj dhe të bërtas me zë të lartë, në atë çast i akuzuari ka hyrë në pjesën e ndarë për punëtorët dhe nga aty ka marr çantën e të dëmtuarës dhe gjatë latgimit përsëri i është kanosur se do ta godas me thikë të dëmtuarën,-

- me këtë ka kryer veprën penale, Grabitja nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4; 7; 17; 21; 41; 42; 43; 45; 46; 73; 74; 75; 76 dhe 83 KPRK-së dhe neneve 248; 359 dhe 365; 366 të KPP-së të akuzuarit e:

## **G J Y K O N**

- **Dënim me BURGIM** në kohëzgjatje prej **dy (2) viteve**, të cilin dënim do ta vuan në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës **12.12.2017** deri më datë **27.02.2018**, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar dhe

- **Dënim me GJOBË** në shumë prej **njëqind (100 €) Euro**, të cilën gjobë obligohet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në qoftëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar dhe nëse e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së do ti shëndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo njëzet euro (20) do ti llogaritet një ditë burg, si dhe i shqipton edhe

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurës penale të paguaj shumën aq sa do të llogaritet sipas shpenzimeve përfundimtare të gjykatës, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **njëzet euro (20) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

Me aktvendim të veçantë PKR.nr.387/17, të datës 27.02.2018, të akuzuarit A.Z i është ndërprerë masa e arrestit shtëpiak.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.254/2017, të datës 19.12.2017, kundër të akuzuarit A.Z, për shkak të veprës penale, Grabitja nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.02.2018 ku prezantuan Prokurori i Shtetit, Hivzi Bajraktari, i akuzuari A.Z me mbrojtësin e tij, av.G.H sipas autorizimit dhe e dëmtuara-dëshmitare V.K.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari A.Z deklaroi se pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.G.H e duke i ditur pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë të cilën pranim e bëri në mënyrë të vullnetshme dhe pa presion dhe theksoi se është penduar shumë për veprimet e ndërmarra, ka shprehur keqardhje, se është hera e parë që ka rënë në konflikt me ligjin duke i premtuar gjykatës se më nuk do të përsërisë, me të dëmtuarën dhe familjen e saj janë pajtuar dhe i ka kërkuar falje edhe publikisht por i ka kërkuar edhe menjëherë pas rastit përmes pronarit të lokalit, i njëjti jeton në gjendje të rëndë ekonomike, shpirtërore dhe shëndetësore, dy gishtat e dorës së djathtë i ka të këputur, është kryefamiljar, baba i katër fëmijëve, jeton në bashkësi familjare me prindër me babin e sëmurë dhe punon kohë pas kohe punëtorë krahu e realizon pensionin e veteranit të luftës dhe kërkoi nga gjykata shqiptimin e një dënimi sa më të butë, për arsye të lartcekura.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.Z, av. G.H, deklaroi se pranimi i fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij është bërë që në stadin e parë të procedurës ku i njëjti vet ka insistuar që të pranoj fajësinë dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet tjera për ti kërkuar falje palës së dëmtuar, është konsultuar mjaftueshëm me të si mbrojtës e duke i ditur pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë dhe i vetëdijshëm e në mënyrë vullnetare e ka pranuar fajësinë, i njëjti është i plagosur gjatë luftës ku ka humbur edhe gjymtyrët e trupit, është i goditur edhe në kokë e që vërteton edhe ekspertiza mjeko ligjore ku thekson se tek i njëjti është konstatuar çrregullim i përshtatjes, emocioneve dhe sjelljes, e duke marrë për bazë faktin se është i gjendjes tejet të rëndë ekonomike, sociale, shëndetësore të tij dhe të familjarëve të cilët janë në mbajtje të tij, nuk ka të kaluar kriminale, si dhe premtimin tejet serioz dhe bindes që i njëjti asnjëherë nuk do të ndërmarrë asnjë veprim i cili është në kundërshtim me ligjin, në mënyrë tejet të disiplinuar ju ka përmbajtur masës së arrestit shtëpiak, nga kjo vepër penale nuk ka përfituar asgjë dhe nuk ka asnjë person të lënduar, kërkoi nga gjykata që marrë parasysh të gjitha të cekurat më lartë ti aplikoj të gjitha mundësitë ligjore për zbutjen e dënimit dhe ti shqiptohet një dënim i kushtëzuar me bindjen e plotë që tek i njëjti do të arrihet në mënyrë të plotë qëllimi i dënimit siç parashihet edhe me nenin 41 të KPK-së.

Prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari A.Z, ngase i njëjti pranim është në përputhje me nenin 248 par.1

të KPP-së dhe në përputhshmëri me dispozitivin e akuzës e cila është e mbështetur në provat të bashkangjitura në shkresat e lëndës andaj propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes dhe lartësisë së shqiptimit të dënimit.

E dëmtuara – dëshmitarja V.K, lidhur me pranimin e fajësisë deklroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, prej tij ka pranuar edhe kërkim fajlën e bërë publikisht në gjykatore i cili po ashtu edhe menjëherë pas rastit i kishte kërkuar fajle përmes pronarit të lokalit ku ishte duke punuar, përveç frikës tjetër dëm nuk kishte pësuar dhe nuk parashtrroi kërkesë pasurore juridike.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda dhe pas marrjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga prokurori i shtetit, mbrojtësi dhe e dëmtuara, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet Gjykata nuk administroj prova por vetëm vlerësoj se në veprimet e të akuzuarit A.Z, formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale, Grabitja nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që si rrethana posaçërisht lehtësuese gjeti se: i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale nga fillimi i procedurës, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, gjendjen e dobët ekonomike dhe shëndetësore, se është kryefamiljar dhe baba i katër fëmijëve, jeton në bashkësi familjare edhe me prindin e sëmurë për të cilët duhet të kujdeset për mbajtjen e tyre, ngase është i vetmi mbajtës i familjes, sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale, për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të kundërligjshme dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale se i ka kërkuar falje palës së dëmtuar e cila ka pranuar kërkim fajlën e tij, pala e dëmtuar u pajtuar me pranimin e fajësisë nuk parashtrroi kërkesë pasurore juridike, ndërsa rrethanë rënduese gjykata mori peshën e veprës penale dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, mirëpo edhe përkundër se gjeti edhe rrethanat rënduese por duke u nisur nga rrethanat posaçërisht lehtësuese të lartcekura, gjykata aplikoi dispozitat e nenit 74, 75 dhe 76 të KPRK-së, për zbutjen e dënimit të akuzuarit dhe i shqiptoj dënimin nën kufirin e paraparë ligjor për këtë veprë penale dhe dënimin me gjobë bazuar në gjendjen ekonomike, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73 par.2 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesve si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së, ndërsa lartësia e paushallit gjyqësor u përcaktua duke pasur parasysh gjendjen financiare të të akuzuarit.

Vendimi mbi ndërprerjen e masës së arrestit shtëpiak, është marrë në bazë të nenit 367 par.1 pika 1.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në masën e së arrestit shtëpiak, është marrë në bazë të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në diapozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr.387/17, datë 27.02.2018**

**Sekretarja juridike**  
**Lindita Sylejmani**

---

**Kryetarja e trupit gjykues - Gjyqtarja**  
**Valbona Musliu-Selimaj**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.